



PËRMIRËSIMI I BASHKËPUNIMIT BULETINI

i programeve IPA BNK Mal i Zi -
Shqipëri dhe Mal i Zi - Kosovë 2014-
2020 dhe 2021-2027

Prill
2024

FOTO: PROJEKTI UJËMBLEDHËSI I LIQENIT TË SHKODRËS - NJË REZERVUAR I BIOSFERËS
NDËRKUFITARE

PËRMBAJTJA

Edicioni i nëntëmbëdhjetë i buletinit ju sjell informacione mbi aktivitetet e zbatuara në kuadër të dy programeve IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri dhe Mal i Zi - Kosovë* 2014-2020 dhe 2021-2027. Programet dhe aktivitetet e projektit financohen nga Bashkimi Evropian.

Më shumë informacione për programet mund të gjeni më poshtë.

Programi IPA III BNK Mal i Zi - Shqipëri 2021-2027

Qellimi i përgjithshëm i programit është të promovojë marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, të nxisë integrimin në Bashkimin dhe të kontribuojë në zhvillimin social, ekonomik dhe territorial duke përmirësuar cilësinë e jetës së popullsisë në zonën ndërkufitare të programit nëpërmjet zhvillimit të turizmit bazuar në trashëgiminë kulturore/natyrore dhe duke mbrojtur mjedisin.

Klikoni [këtu](#) për më shumë informacione.

Programi IPA III BNK Mal i Zi- Kosovë 2021-2027

Qellimi i përgjithshëm i programit është të promovojë marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, të nxisë integrimin në Bashkimin dhe të kontribuojë në zhvillimin social, ekonomik dhe territorial të zonës ndërkufitare të programit duke përmirësuar punësimin, lëvizshmërinë e punës dhe përfshirjen sociale dhe kulturore përtej kufijve; dhe zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm.

Klikoni [këtu](#) për më shumë informacione.

- »»» Konferenca Përfundimtare feston Arritjet e Bashkëpunimit Ndërkufitar ndërmjet Malit të Zi dhe Kosovës.....2
- »»» IPA II Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi- Shqipëri feston arritjet në Podgoricë.....3
- »»» Të reja nga projektet në Thirrjen e III-ë të Programit IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri.....5
- »»» Të reja nga projektet në Thirrjen e III-ë të Programit IPA BNK Mal i Zi – Kosovë7
- »»» Takimi dypalësh në Prishtinë.....12
- »»» Mblidhen në Tiranë Strukturat Operuese të Programit.12

Ky publikim është prodhim i mbështetjes financiare të Bashkimit Evropian. Përbajtja e saj është përgjegjësi e Sekretariatit të Përbashkët Teknik të Programeve IPA BNK Mali i Zi - Shqipëri dhe Mali i Zi-Kosovë dhe nuk paraqet domosdoshmërisht mendimet e Bashkimit Evropian.

*Ky shënim është pa paragjykim të pozicioneve për status dhe është në linjë me RKS KB 1244 dhe Opinionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

CBC ZOOM

Konferenca Përfundimtare feston Arritjet e Bashkëpunimit Ndërkufitar ndërmjet Malit të Zi dhe Kosovës

Në Prishtinë, më 29 mars të vitit 2024, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal të Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me Ministrinë e Çështjeve Evropiane të Malit të Zi, e organizojë "Konferencën Përfundimtare të IPA II Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi - Kosovë 2014-2020". Aktiviteti festoi sukseset e programit dhe prezantoi Programin e ardhshëm IPA III për periudhën 2021-2027.

Ministri i Administratës së Pushtetit Lokal të Republikës së Kosovës, **Elbert Kransiqi**, në fjalën e tij hyrëse, vlerësoi bashkëpunimin mes Malit të Zi dhe Kosovës si një histori suksesi në marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë. Ai theksoi sesi programi ka përmirësuar standardet e jetesës përmes zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, ekologjik dhe social duke respektuar trashëgiminë kulturore dhe natyrore. **Kransiqi** shprehu mirënjohjen për të gjithë partnerët dhe kërkoi vazhdimin e bashkëpunimit për ndikim edhe më të madh në të ardhmen.



Ministrja e Çështjeve Evropiane të Malit të Zi, **Maida Gorçeviq**, foli për rendesinë e kësaj konference, duke theksuar se bashkëpunimi ndërkufitar ka trajtuar në mënyrë efektive sfidat e përbashkëta. Ajo vuri në dukje se programi IPA II mbështeti 24 projekte me vlerë mbi 9 milionë euro, duke mbuluar fusha të tilla si punësimi, përfshirja sociale, mbrojtja e mjedisit, përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike, menaxhimi i rrezikut nga fatkeqësitë dhe zhvillimi i turizmit. Gorçeviq shprehu besimin për bashkëpunim edhe më të fortë në të ardhmen dhe shfrytëzimin e zgjeruar të fondeve evropiane.



Alessandro Biankardi, Zëvendës Shef i Seksionit për Bashkëpunim në Zyrën e BE-së në Kosovë, vlerësoi programin si një testament për përkushtimin e Bashkimit Evropian për të nxitur unitetin,



prosperitetin dhe paqen në Evropë. Ai theksoi përfitimet e prekshme të investimit në punësim, mjedis, turizëm dhe trashëgimi kulturore.



Pas kësaj, **Sanja Todorović**, udhëheqëse e Sekretariatit të Përbashkët Teknik, prezantoi statistika gjithëpërfshirëse dhe të arriturat e Programit IPA II. Ajo prezantoi në detaje numrin e thirrjeve për dërgimi e projekt-propozime të publikuara, mbështetjen e ofruar për aplikantët dhe përfituesit e projektit, si dhe përfshirjen e institucioneve dhe përfituesve të drejtpërdrejtë. Todorović gjithashtu



Konferenca paraqiti një panel diskutimi tërheqës me përfituesit e projektit të moderuar nga Gazmir Raci, Zyrtar i Projektit në Sekretariatit e përbashkët në Prishtinë. **Jelena Krivčević** nga Agjencia për Zhvillim Rajonal për Bjelasica, Komovi dhe Bjeshkët e Nemuna në Mal të Zi ndau përvojën e saj në projektet e turizmit rural dhe aktiv. Ajo theksoi sesi fondet e BE-së ndihmuan në transformimin e fermave bujqësore në objekte të turizmit rural, duke rritur kapacitetet dhe të ardhurat lokale nëpërmjet aktiviteteve të turizmit të qëndrueshëm. **Blerta Begolli** nga Komuna e Pejës diskutoi për projektet e trashëgimisë kulturore që nxisin turizmin dhe zhvillimin ekonomik. Ajo theksoi reagimet pozitive nga turistët dhe rritjen e të ardhurave për familjet rurale të përfshira në rrugët e trashëgimisë kulturore. **Xhevahire Gusturanaj**, një përfituese e drejtpërdrejtë, tregoi se si investimet e vogla si panelet diellore përmirësonin prodhimin bujqësor dhe lehtësuan shërbimet e turizmit rural, duke rritur cilësinë e jetës në zonat e thella. Për më tepër, **Arta Gorani** nga OJQ-ja Fondi për Zhvillimin e Komunitetit diskutoi për projektin "TIMETRAVEL", prezantoi projektin i cili synon të zhvillojë një shteg të ri turistik kulturor dhe historik që lidh Kosovën dhe Malin e Zi.

Në seancën përmbyllëse, **Todorović** e paraqiti programin e ri IPA III BNK Mali i Zi - Kosovë 2021-2027, duke detajuar prioritetet e tij, kornizën financiare dhe entitetet e pranueshme. Ajo njoftoi se thirrja e parë për propozime do të publikohet në vitin 2024 dhe ftoi të pranishmit të marrin pjesë në ngjarjet e ardhshme për ndërtimin e kapaciteteve. Konferenca, ku morën pjesë mbi 102 pjesëmarrës, nënvizoi vlerën e qëndrueshme të bashkëpunimit ndërkufitar dhe hapi terrenin për përpjekjet e ardhshme bashkëpunuese, duke siguruar përparim dhe zhvillim të vazhdueshëm si për Malin e Zi ashtu edhe për Kosovën.



IPA II Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi-Shqipëri feston arritjet në Podgoricë

Ministria e Çështjeve Europiane e Malit të Zi, në bashkëpunim me Agjensinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC) e Shqipërisë, organizuan në Podgoricë me datë 2 prill të vitit 2024 Konferencën Përmbyllëse të IPA II të Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi-Shqipëri 2014-2020. Ky event theksoi suksesin e projekteve të zbatuara, ndau praktikat më të mira me publikun si dhe prezantoi programin e ri IPA III për periudhën 2021-2027.

Bojan Bozhović, Sekretari i Shtetit në Ministrinë e Çështjeve Europiane dhe njëkohësisht Koordinator Kombëtar i IPA-së i Malit të Zi, vlerësoi përpjekjet për bashkëpunim që kanë forcuar lidhjet ndërmjet Malit të Zi

dhe Shqipërisë duke adresuar problematikat në fushën e punësimit, mobilitetit të krahut të punës,



përfshirjes sociale dhe kulturore, mbrojtjes së mjedisit dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike "Marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunimi rajonal janë kyç për anëtarësimin në BE" theksoi ai.



Jona Sulj, Drejtoreshë e Përgjithshme e SASPAC dhe njëkohësisht Kordinatore Kombëtare e IPA së Shqipërisë përcolli të njëjtat ndjesi, duke theksuar angazhimin e të dy vendeve në të ardhmen e përbashkët europiane. Ajo veçoi interesin e veçantë dhe arritjet e përfituesve të projekteve duke njohur mësimet e nxjerra dhe potencialin për të përmirësuar performancën përgjatë fazës së ardhshme të programit.





Sanja Beçanoviç,

Drejtoreshë e Përgjithshme në detyrë e Drejtorisë së Financave, Kontraktimit dhe Zbatimit të Fondeve Ndihmë të BE-së në Malë të Zi, falenderoi pjesëmarrësit për përkushtimin e tyre ndaj projekteve ndërkufitare. Ajo veçoi rolin e programit në nxitjen e zhvillimit socio-ekonomik dhe marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, ndërsa theksoi nevojën për bashkëpunim të vazhdueshëm dhe optimizim të procesit.

dhe përfituesve. **Sanja Todoroviç**, Shefe e Sekretariatit të Përbashkët Teknik, ndau në vijim me të pranishmit arritjet kryesore të projekteve duke u përqëndruar në ndikimet konkrete sipas fushave respektive të zbatimit.

Konferenca përfshinte gjithashtu një panel diskutimesh mbi mbrojtjen e mjedisit, adaptimet ndaj ndryshimeve klimaterike dhe menaxhimit të risikut e moderuar nga **Nikolla Gjonoviç**, nëpunës i Sekretariatit të Përbashkët Teknik. Ndër panelistë bënin pjesë **Vesellin Shturanoviç** nga FORS Mali i Zi dhe **Andris Tufi** nga Prefektura Shkodër, të cilët diskutuan mbi projektet "Fatkeqësitë nuk njohin kufinj". Ata theksuan kontributet e projekteve në zvogëlimin e rreziqeve të fatkeqësive, përgatitjen ndaj emergjencave dhe në krijimin e një Sistemi të Përbashkët Lajmërimi për Liqenin e Shkodrës. **Danjela Shukoviç** nga Qendra për Hulumtime Ekotoksikologjike e Malit të Zi prezantoi projektin "SOLUTION" i cili ka përmirësuar cilësinë e ujit të Liqenit të Shkodrës duke garantuar konsumimin e peshkut të sigurtë dhe shëndetin mjedisor. **Ermelinda Isufaj** nga Qendra EDEN Shqipëri dhe **Ana Katniç** nga Qendra EnvPro e Malit të Zi diskutuan lidhur me projektin "Liqeni i Shkodrës-një Reservuar i Biosferës Ndërkufitare" duke theksuar se ky bashkëpunim synonte mërtimin e UNESCOs dhe menaxhimin e qëndrueshëm të ekosistemit. Paneli nënvizoi gjithashtu rëndësinë e bashkëpunimit ndërkufitar, monitorimin shqencor dhe planifikimin proaktiv për qëndrueshmërinë mjedisore.



Ndërsa foli për të pranishmit, **Liselot Isakson**, zv.Shefja e Bashkëpunimit në Delegacionin e BE-së në Mal të Zi lavdëroi nismat për sa i përket efikasitetit të tyre në zgjidhjen e sfidave të përbashkëta dhe shfrytëzimin e mundësive të zgjerimit. Ajo gjithashtu njoftoi se BE-ja do të sigurojë përafërsisht 12 milion euro në formë granti për programin e ri IPA III.



Në sesionin përmbyllës, **Sanja Todoroviç** përsëriti mësimet e dala nga Programi IPA II dhe prezantoi për të pranishmit Programin e ri IPA III të Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi-Shqipëri 2021-2027 bashkë me prioritetet programatike, strukturën financiare, entitetet e lejuara për aplikim duke ftuar kështu të pranishmit që të përfshihen në aktivitetet e ardhshme kapacitet-ndërtuese. Kjo konferencë e cila mboldhi 60 pjesëmarrës duke përfshirë zyrtarë nga strukturat operuese të të dy shteteve, delegacionet e BE-së, qeverisjet lokale dhe shoqëritë civile, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërkufitar dhe shtroi terrenin për përpjekje të vazhduara për bashkëpunim me qëllim rritjen e bashkëpunimit dhe integritimit rajonal.



Në vijim, **Nersada Mandija**, nëpunëse e Antenës së Programit në Shkodër, prezantoi statistika të detajuara lidhur me programin IPA II, duke përfshirë numrin e Thirrjeve për dërgimin e projekt-propozime, mbështetjen e dhënë për aplikantë si dhe përfshirjen e institucioneve



Te reja nga projektet e financuara në thirrjen e III-të të programit IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri

Zhvillohen trajnime për të papunët në Cetinë dhe konsultime në Fushë Arrëz

Përgjatë muajit prill të vitit 2024, në kuadër të projektit "S'ka Kufinj për Punë!" janë mbajtur trajnime për personat e papunësuar. Për përfituesit malazez, pjesa e parë e trajnimeve teorike për të papunët u zhvillua në Qendrën e Biznesit Cetinë. Trajnimet iu përkushtuan aftësive të komunikimit në vendin e punës dhe rritjes së vetëbesimit, motivimit dhe tejkalimit të konflikteve. Në përfundim të trajnimit teorik, për kandidatët e përzgjedhur do të ofrohet trajnim praktik në punëdhënësit e përzgjedhur.



Ndërsa në Shqipëri, përfaqësues nga bizneset lokale, institucionet dhe agjensitë private dhe shtetërore u mblodhën në një takim për të dhënë sugjerime lidhur me Planin e Veprimit për punësim në Bashkinë Fushë Arrëz dhe Malësi e Madhe. Të pranishmit u përfshinë në diskutime aktive duke siguruar rekomandime lidhur me trajnimin e përshtatshëm të grupeve të marginalizuara të zonës.



Projekti "S'ka Kufinj për punë!" zbatohet nga një konsorcium partnerësh të udhëhequr nga Kryeqyteti i Vjetër Mbretëror i Cetinës, ProAct Hub, Instituti për Politika të Qëndrueshme dhe Bashkia Fushë Arrëz dhe synon të përmirësojë zhvillimin gjithëpërfshirës ekonomik të zonës kufitare të Fushë Arrëzit, Malësisë së Madhe dhe zonës së Cetinës dhe Podgoricës.



Paisje të reja për Ndërmarrjet Komunale të Gucisë dhe Pukës

Në Guci, u blenë dhe u shpërndanë nëntë kostume për stafin që përfshinin xhaketa, pantallona, këpucë pune dhe mushama shiu duke kaluar kështu edhe planifikimin fillestar prej pesë kostumesh. Gjithashtu janë instaluar edhe pesë kontenerie për letër dhe 16 kosha për ndarjen e mbetjeve. Të tjera ndërhyrje në Guci parashikojnë prokurimin e njësie të komunikimit të lëvizshëm, stacione digjitale radioje dhe stola diellor të planifikuara për instalim përgjatë rrugës kryesore, e cila aktualisht është në ndërtim. Ndërsa për Bashkinë Pukë është dorëzuar një kamion pastrimi i cili është tani në përdorim të ndërmarrjes komunale. Po ashtu nga ky projekt është bërë i mundur prokurimi i tetë kontenerëve për mbeturina dhe 16 koshave për ndarjen e mbetjeve. Për Bashkinë Pukë, përforcimet e radhës parashikojnë prokurimin e njësie të komunikimit të lëvizshëm, stacione digjitale radioje si dhe veshje mbrojtëse për punonjësit në sektorin e pastrimit. Njëjtë me Gucinë, edhe në Pukë do të prokurohen dhe instalohen stola diellorë pranë zonës së liqenit si zona më e frekuentuar nga vizitorët në mënyrë që të garantohet përdorimi i zgjatur nga banorët dhe vizitorët.



Komuna e Gucisë dhe Bashkia Pukë po zbatojnë sëbashku projektin "Aksioni i Përbashkët i Mbrojtjes së Mjedisit-JEPA".



Mbahet punëtorja e mentorimit të bizneseve

Përgjatë kësaj periudhe, partnerët zbatues të projektit "Aftësi për Punë Shqipëri-Mali i Zi" kanë vazhduar me aktivitete për ngritjen e kapaciteteve. Gjithashtu, Agjencia Shqiptare për Investime dhe Zhvillim (AIDA), ka publikuar thirrjen e hapur për aplikime për të bërë të mundur përzgjedhjen e të rinjve (15-29 vjeç) dhe grave të papuna që do të mbështeten në ngritjen e bizneseve të tyre përgjatë zonës së Bashkisë Shkodër, Vau Dejës dhe Malësi e Madhe.



Funded by
the European Union



AIDA



THIRRJE PËR APLIKIM

IPA CBC PROGRAMME MONTENEGRO-ALBANIA 2014-2020

THIRRJE PËR APLIKIM PËR PËRZGJEDHJEN E TË RINJVE (GRUPMOSHA 15-29 VJEÇ) DHE GRA TË PAPUNA PËR MBËSHTETJE NË FILLIMIN E BIZNESIT TË TYRE NË ZONËN E BASHKISË SHKODËR, BASHKISË VAU I DEJËS DHE BASHKISË MALËSI E MADHE



Ky projekt po zbatohet nga Fodacioni Qendra e Bizneseve Start-Up Tivar, Dhoma e Ekonomisë e Malit të Zi dhe Agjencia Shqiptare për Investime dhe Zhvillim.

Realitet i Ri për Sitet e Trashëgimisë

Projekti "Realitet i Ri për Sitet e Trashëgimisë" synon që të kontribuojë në zhvillimin e turizmit, kulturës dhe trashëgimisë në Ma të Zi dhe Shqipëri dhe po zbatohet nga komuna e Tivarit në bashkëpunim me partnerët shqiptarë të Bashkisë Tropojë dhe Fondacionit për Autonomi Vendore dhe Qeverisje (FLAG). Partnerët e projektit janë aktualisht në fazën e

prokurimit dhe parapërgatitjeve për ekzekutimin e punimeve në Qytetin e Vjetër të Tivarit dhe në Muzeun e Tropojës.

Ndërtojmë Pyje të Zgjuara

Partnerët e projektit "Ndërtojmë Pyje të Zgjuara" kanë vazhduar me aktivitete ndërgjegjëse dhe përgatitjen e procedurave për prokurimin e paisjeve të vlefshme që do të bëjnë të mundur detektimin në kohë reale të zjarreve në zonën ndërkufitare.



Co-funded by
the European Union



MNE-ALB
IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-ALBANIA 2014-2020



FLAG
CENTRE FOR LOCAL GOVERNMENT CO-OPERATION



BUILDING
SMART
FORESTS



Projekti "Ndërtojmë Pyje të Zgjuara" po implementohet nga Fondacioni për Autonomi Lokale dhe Qeverisje (FLAG) nga Shqipëria, në partneritet me komunën e Tivarit dhe Bashkinë Shkodër.

Mbahet Punëtorja Kombëtare mbi vlerat natyrore, shërbimet e ekosistemit dhe benefitet njerëzore

Përgjatë muajit prill të vitit 2024, u mbajt në Mal të Zi Punëtorja e Parë Kombëtare me titull "Eksplorojmë Vlerat Natyrore, Shërbimet e Ekosistemit dhe Benefitet Njerëzore" ku pjesëmarrësve iu dha mundësia të diskutojnë elementet funksionale të rezervuarëve të biosferës.



Përkatesisht, kjo punëtorja bëri sëbashku 30 përfaqësues të grupeve të interesit nga Mali i Zi duke nxitur shkëmbime dinamike dhe përforcuar marrëveshtjen që do të drejtojnë ruajtimin e rezervuarit të biosferës.



Projekti "Ujëmbledhësi i Liqenit të Shkodrës - një Rezervuar i Biosferës Ndërkufitare" po zbatohet nga Qendra për Zhvillim, Arsimit dhe Rrjetëzim (EDEN), Programi Mjedisor-EnvPro, Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura në Shqipëri si dhe Ndërmarrja publike e Parqeve Kombëtare e Malit të Zi.

Të reja nga projektet e financuara në thirrjen e III-të të programit IPA BNK Mal i Zi - Kosovë

Një varg aktivitete të realizuara në komunën e Tuzit dhe Pejës

Komuna e Tuzit, në partneritet me komunën e Pejës, është duke zbatuar projektin "Qasja e Revitalizimit të Mjedisit – NERA" që do të kontribuojë në mbrojtjen e mjedisit përmes një qasjeje të orientuar strategjikisht në komunitetet lokale në Mal të Zi dhe Kosovë. Kjo iniciativë synon mbrojtjen dhe rigjallërimin e mjedisit nëpërmjet veprimeve strategjike të komunitetit dhe aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve.



Një nga pikat kryesore të projektit NERA ishte trajnimi "Menaxhimi i konceptit të zero mbetjeve". Përfaqësuesve të ndërmarrjeve publike në Pejë dhe Tuzi iu dha mundësia të vizitoheshin dy kompani pioniere në krye të inovacionit të riciklimit. Ata vëzhguan proceset e ndërlikuara të përfshira në riciklimin e qelqit, plastikës dhe letrës dhe panë nga dora e parë se si këto materiale shndërrohen në produkte të vlefshme.

Gjatë muajit mars dhe prill të vitit 2024, janë mbajtur katër punëtori për nxënësit e klasave të shtatë, tetë dhe nëntë të shkollave fillore në Tuz. Punëtoritë, të cilat përfshinin pjesëmarrje si nga nxënësit ashtu edhe nga stafi i shkollës, u fokusuan në tema kritike si ndotja nga mbetjet, llojet e veçanta të mbetjeve, ndarja e mbetjeve dhe riciklimi. Këto sesione edukative synonin të nxinin ndërgjegjen e fortë mjedisore tek brezi i ri.



Në kuadër të projektit, qeset plastike të biodegradueshme iu dorëzuan K.R.M Ambienti për t'u shpërndarë në 840 familje në Pejë. Çanta, të dizajnuara me ngjyra të ndryshme, synojnë të inkurajojnë ndarjen e duhur të mbetjeve, duke thjeshtuar procesin e riciklimit për banorët.



Përveç aktiviteteve edukative dhe ndërgjegjëse, NERA ofroi gjithashtu mjete thelbësore pastrimi dhe mirëmbajtjeje për organizatat

lokale. EKO-SIG mori karroca dore, gërrshërë mbrojtëse dhe lopata për të mbështetur përpjekjet e tyre të vazhdueshme në ruajtjen e hapësirave të pastra dhe të bukura të komunitetit.

Projekti trajtoi gjithashtu çështjen e rëndësishme të deponive të paligjshme. Janë mbajtur takime koordinuese me aktorë të ndryshëm për të zhvilluar strategji për trajtimin e kësaj sfide. Përpjekja kolektive synon të transformojë këto zona të ndotura në hapësira të gjelbra të gjalla, duke rritur bukurinë e bashkive dhe duke kontribuar për një të ardhme më të shëndetshme dhe më të qëndrueshme.



Ndiqni [fagen](#) e projektit për më shumë informacion.

Projekti UNEETED zbulon rezultatet e hulumtimit mbi të rinjtë NEET në Mojkovac

Më 22 shkurt të 2024 Instituti për Studime dhe Prognoza Strategjike, Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), Oda Ekonomike e Malit të Zi dhe Komuna e Mojkovcit prezantuan hulumtimin e tyre të fundit si pjesë e "Të rinjtë NEET: mundësi të reja për punë dhe rritje të punësimit – "UNEETED".... Prezantimi, i mbajtur në Mojkovac, u fokusua në popullatën NEET (jo në arsim, punësim ose trajnim) në pesë komuna malazeze: Bijello Pole, Guci, Mojkovac, Plavë dhe Rozhaja. Hulumtimi synon të identifikojë sfidat me të cilat përballen të rinjtë NEET dhe të eksplorojë mundësi të reja për përmirësimin e punësueshmërisë së tyre dhe integrimin e tyre në fuqinë punëtore.



Projekti UNEETED i dedikohet krijimit të mundësive të reja të punësimit dhe përmirësimit të aftësive të të rinjve në Mal të Zi, të cilët aktualisht janë jashtë sistemit të arsimit dhe punësimit. Duke adresuar nevojat specifike të popullsisë NEET, projekti synon të nxisë rritjen ekonomike dhe të ulë normat e papunësisë tek të rinjtë në këto rajone. Ky aktivitet shënoi një hap të rëndësishëm në kuptimin dhe adresimin e problemeve me të cilat përballen të rinjtë NEET, duke i hapur rrugën ndërhyrjeve të

synuara dhe programeve mbështetëse për t'i ndihmuar ata të kalojnë në tregun e punës.

Aftësitë për Punësim të Qëndrueshëm në Rajonin Ndërkufitar të Malit të Zi dhe Republikës së Kosovës - Pa Kufi!

Projekti "Aftësitë për Punësim të Qëndrueshëm në Rajonin Ndërkufitar të Malit të Zi dhe Republikës së Kosovës – Pa Kufi!" synon të kontribuojë në rritjen e aftësive dhe kompetencës profesionale të të rinjve dhe grave të papuna në rajonin ndërkufitar me qëllim plotësimin e nevojave për punësim në sektorin e turizmit dhe hotelerisë. Projekti është duke u implementuar nga Oda Ekonomike e Malit të Zi, Oda Ekonomike e Republikës së Kosovës, Qendra Rajonale e Biznesit Berane dhe Instituti për Arsim, Trajnim dhe Hulumtim – ETRI. Partnerët e projektit filluan me aktivitete për ngritjen e kapaciteteve. Përkatesisht, nëntë të rinj nga Berane, Bijello Pole dhe Rozhaja patën mundësinë që në periudhën e ardhshme të fitojnë njohuri bazë për sipërmarrjen, të cilat mund t'i ndihmojnë ata të arrijnë qëllimet e tyre.



Në muajin prill të viti 2024, në ambientet e Qendrës Rajonale të Biznesit u ndanë certifikata për pjesëmarrësit që përfunduan trajnimin në punë. Gjatë trajnimit tre mujor, pjesëmarrësit patën mundësinë të mësojnë nga mentorët e tyre dhe të fitojnë përvojë dhe njohuri të vlefshme në sektorët e turizmit dhe hotelerisë.



Pjesëmarrësit theksuan se kanë përmirësuar njohuritë e tyre, kanë mësuar shumë nga mentorët e tyre dhe se tani janë gati për sfida dhe mundësi të reja që i presin në tregun e punës. Suksesi i tyre është rezultat

i punës dhe motivimit të përkushtuar, si dhe mbështetjes që ata morën nga mentorët dhe organizatat partnere.

CDF organizon punëtori trajnuese në Pejë për të mbështetur grupet vulnerabël

Më 22 shkurt të vitit 2024, Fondi për Zhvillimin e Komunitetit (FZHK) lansoi një seminar dyditor trajnimi si pjesë e projektit "Rilindja Kulturore nga Liqeni i Shkodrës në Kosovë - TIMETRAVEL". Veprimtaria mbledhi së bashku përfaqësues nga institucionet e politikave sociale dhe të punësimit për të diskutuar politikën e aktivizimit që synojnë mbështetjen e grupeve vulnerabël. Punëtorja, e mbajtur në bashkëpunim me Qendrën për Iniciativat e Turizmit të Qëndrueshëm (CSTI) Mali i Zi, Organizatën Kombëtare të Turizmit (NTO) Mali i Zi dhe Komunën e Klinës në Kosovë, kishte për qëllim ngritjen e kapaciteteve të këtyre institucioneve për zbatimin e politikave efektive të aktivizimit. Këto politika janë thelbësore për përmirësimin e përfshirjes sociale dhe ekonomike të popullsisë së marginalizuar.



Pjesëmarrësit u angazhuan në diskutime gjithëpërfshirëse dhe sesione interaktive, duke u fokusuar në praktikën më të mirë dhe strategjitë inovative për të fuqizuar grupet vulnerabël përmes iniciativave për punësim dhe integrim social. Punëtorja ofroi një platformë për shkëmbimin e njohurive dhe përvojave, duke nxitur një qasje bashkëpunuese për adresimin e sfidave me të cilat përballen këto komunitete.



Projekti "Rilindja Kulturore nga Liqeni i Shkodrës në Kosovë - TIMETRAVEL" nënvizon rëndësinë e iniciativave kulturore dhe sociale në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe rritjen e cilësisë së jetës për të gjithë qytetarët. Duke u fokusuar në politikën e aktivizimit, projekti

synon të krijojë komunitete më gjithëpërfshirëse dhe elastike në të gjithë rajonin.

Evokimi dhe tërheqja e trashëgimisë kulturore - Antikiteti i Krishterë dhe Banja Turke për Turizmin Kulturor

Projekti "Evokimi dhe Tërheqja e Trashëgimisë Kulturore – Antikiteti i Krishterë dhe Banja Turke për Turizmin Kulturor" do të kontribuojë në rritjen e konkurrencës ekonomike të zonës duke rritur potencialin turistik kulturor të zonës. Ky projekt është duke u realizuar nga EP Polimjski Muzeu Berane dhe Marimangat e Pejës - Shoqata e Ngjites Shkëmbinore nga ana e Kosovës.



Në kuadër të aktiviteteve të projektit, ekipi i ekspertëve të Muzeut të Polimjes në Berane ka kryer kërkime sistematike arkeologjike të lokalitetit të Tumbaricës.



Bazuar në pjesët e zbuluara dhe të ruajtura të arkitekturës dhe një numër të madh objektiv të rralla muzeale, të gërmuara pas punimeve të financuara nga projekti i mëparshëm në kuadër të Programit IPA BNK Mali i Zi – Shqipëri, Muzeu i Polimjes vendosi të vazhdojë punën e mëtejshme në këtë lokalitet.

Përmes edukimit për të përmirësuar menaxhimin e mbetjeve të ngurta

Më 14 Prill të vitit 2024, në Berane u mbajt një trajnim dy-ditor mbi përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve të ngurta, organizuar nga FORS Mali i Zi dhe Komuna e Beranës, si pjesë e projektit "Marrëveshja e gjelbër ndërkufitare". Trajnimi u organizua për

përfaqësuesit e institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit, shërbimet komunale dhe inspektuese me qëllim forcimin e kapaciteteve të tyre dhe zhvillimin e bashkëpunimit ndërkufitar në këtë fushë. Në trajnim morën pjesë 30 përfaqësues të institucioneve të përmendura të cilët patën rastin të dëgjojnë nga profesori i Fakultetit të Shkencave Teknike të Universitetit të Novi Sadit, prof. Bojan Batiniq dhe prof. Dejan Ubavin mbi mundësitë e përmirësimit të menaxhimit të mbetjeve nëpërmjet njohjes me standardet dhe praktikat moderne në këtë fushë, rëndësinë e ekonomisë rrethore në menaxhimin e mbetjeve, projektimin dhe planifikimin e hapësirës, masat për rehabilitimin e tyre, etj.



Projekti "Marrëveshja e gjelbër ndërkufitare" i zbatuar nga FORS Mali i Zi, ECMI Kosova dhe Komuna e Beranës synon të përmirësojë cilësinë e shërbimeve në sektorin e mbrojtjes së mjedisit dhe menaxhimit të mbeturinave dhe të rrisë nivelin e ndërgjegjësimit të popullatës për rëndësinë e sjelljes së përgjegjshme mjedisore në ruajtjen e mjedisit dhe burimeve natyrore.

Turizmi për të Ardhmen

Projekti dyvjeçar "Turizmi për të Ardhmen" zbatohet nga OJQ Prishtina REA si partner lider në partneritet me Shoqatën Alpiniste "Gjeravica" nga Kosova dhe partnerët malazezë, Komunën e Kollashinit dhe Institutin për Ndërmarrësi dhe Zhvillim Ekonomik.



Gjatë tremujorit të parë të vitit 2024, u prodhuan një sërë videosh promovuese. Një prej tyre ishte historia e Elite Apartments Kolasin ku mysafirët mund të shijojnë apartamente komode dhe tarraca piktoreske. Më shumë për këtë vend të qetësisë mund të gjeni këtu. Shikoni historinë [këtu](#).

Ndërkohë, në Pejë (Kosovë), historia dhe trashëgimia e mjeshtërisë tradicionale vazhdon përmes Blerim Goranit, trashëgimtar i një vargu të gjatë artizanësh të aftë që datojnë nga shekulli i 19-të. Blerimi ofron gërvshërë dhe brisqe autentike të bëra nga briri i dashit, të pasura me

histori dhe traditë. Dyqani i tij tërheq turistë vendas dhe ndërkombëtarë, të etur për të përjetuar dhe blerë këto produkte unike vendase. Për një paraqitje të shkurtër në këtë traditë, shikoni videon promovuese [këtu](#).



Në kuadër të aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve, në Kolasin u mbajt trajnimi mbi standardet ndërkombëtare eko-miqësore, trashëgiminë kulturore, natyrën dhe mjedisin si vlerë të eko-turizmit. Për më tepër, trembëdhjetë përfitues nënshkruan Marrëveshje Granti për të zbatuar dhe arritur standarde të etiketës ekologjike të njohura ndërkombëtarisht dhe të certifikohen. Ceremonia theksoi rëndësinë e praktikave eko-miqësore në turizëm. Një video nga ngjarja është në dispozicion [këtu](#), dhe një përmbledhje e statistikave të pjesëmarrjes në trajnim mund të shihet [këtu](#).

Si paralajmërim, tashmë kanë filluar përgatitjet për **Festivalin e Turizmit në Pejë**, i cili do të organizohet në maj. Ky festival premtion të shfaqë bukurinë dhe aventurën që ka për të ofruar Peja, duke promovuar turizmin e qëndrueshëm dhe traditat lokale.

C.L.O.S.E.R. - Mundësi të udhëhequra nga kultura për rivitalizimin e qëndrueshëm ekonomik

Fondacioni i Kosovës për Trashëgimi Kulturore pa Kufij, në partneritet me Komunën e Tivarit po zbaton një projekt dyvjeçar C.L.O.S.E.R. – Mundësi të udhëhequra nga kultura për rivitalizim të qëndrueshëm ekonomik. Punëtorja e dytë që synon "Zhvillimin e Planit të Menaxhimit të Qendrës Creative Hub West" ka përfunduar me sukses, duke shënuar një moment historik të rëndësishëm në formësimin e së ardhmes së komunitetit krijues të rajonit në zhvillim.



Punëtorja është mbajtur gjatë janarit të vitit 2024 me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të shoqërisë civile nga i gjithë rajoni perëndimor i Kosovës, duke përfshirë Pejë, Gjakovën, Deçanin, Klinën, Istogun dhe Junikun, përfshirë edhe institucione zyrtare relevante.. Kjo përpjekje bashkëpunuese nënvizon përkushtimin për ta bërë Creative Hub West jo vetëm një hapësirë, por një iniciativë dinamike dhe gjithëpërfshirëse të drejtuar nga komuniteti.



Diskutimet ishin të gjera dhe të detajuara, duke u fokusuar në kuadrin strukturor të HUB-it dhe duke identifikuar rolet vendimtare në procesin e menaxhimit të tij. Pjesëmarrësit ndanë njohuri dhe perspektiva, duke u siguruar që HUB-i pasqyron nevojat dhe aspiratat e ndryshme të komuniteteve lokale të cilave synon t'u shërbejë.

Punëtorja për Trashëgimia Kulturore në Turizëm Rural u mbajt në Pejë

Si pjesë e projektit "Shndërrimi i fshatrave tona në destinacione turistike", AZHR-Perëndim me mbështetjen e Komunës së Pejës organizoi një punëtori më 31 janar të vitit 2024, me temë Roli i Trashëgimisë Kulturore në Turizmin Rural. Qëllimi i seminarit ishte iniciimi i procesit të zhvillimit të kapaciteteve në komunitetet rurale për shfrytëzimin e trashëgimisë kulturore në ofrimin e shërbimeve turistike, si dhe ruajtjen dhe prezantimin e këtyre vlerave nga bizneset dhe familjet që do të ofrojnë shërbime në turizmin rural në të ardhmen.



Gjatë seminarit, u morën parasysh edhe mësimet e nxjerra nga vizitat studimore të kryera në Mal të Zi në vendet ku ofrohen shërbimet e turizmit rural. Ky projekt dyvjeçar financohet nga BE-ja përmes IPA Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi-Kosovë.



Në Punësim, Arsim, Trajnim - IN EET

Për të kontribuar në përfshirjen sociale të grupeve të cenueshme të popullsisë, si dhe aksesin e tyre në tregun e punës, OJQ Juventas nga Mali i Zi dhe OJQ Labyrinth nga Kosova po zbatojnë projektin "Në Punësim, Arsim, Trajnim - IN EET".



Në datat 22 dhe 23 shkurt të vitit 2024 u mbajt një takim i përbashkët në kuadër të projektit. Në këtë takim ishin të ftuar mysafirë zyrtarë të institucioneve përkatëse publike të çështjeve sociale dhe punësimit nga Mali i Zi dhe Kosova.



Gjithashtu u prezantua edhe hulumtimi i prodhuar si pjesë e projektit, i cili përmbante informacione për situatën në Kosovë dhe Mal të Zi për mundësitë sociale dhe mundësitë e punësimit për grupet e marginalizuara. Pjesëmarrësit patën mundësinë të diskutojnë mbi

rezultatet e hulumtimit dhe të ofrojnë zgjidhje dhe rekomandime se si të përmirësohet situata në Kosovë dhe Mal të Zi.



Takimi dypalësh në Prishtinë

Më 18 mars të vitit 2024, në Prishtinë u organizua një takim dypalësh ndërmjet strukturave të IPA Programit të BNK-së Mali i Zi – Kosovë për të diskutuar programin e ri IPA III dhe aktivitetet aktuale të Programit në kuadër të IPA II.



Gjatë takimit u diskutuan aspekte të ndryshme të hapave të ardhshëm në lidhje me publikimin e Thirrjes së parë për dërgimin e projekt-propozimeve në kuadër të Programit IPA III, si dhe organizimi i eventeve finale në kuadër të IPA II.




Mblidhen në Tiranë Strukturat Operuese të Programit

Me 26 janar të vitit 2024, në Tiranë, në ambjentet e Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës në Republikën e Shqipërisë (SASPAC) u mbajt takimi i radhës i Strukturave Operuese të programit me qëllim diskutimin e aktiviteteve të ardhshme.



Përkatesisht, SASPAC dhe përfaqësues të Ministrisë së Çështjeve Europiane të Malit të Zi dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal të Republikës së Kosovës diskutuan dhe dakordësuan lidhur me aktivitetet e propozuara të Asistencës Teknike nën IPA III dhe aktivitetet në vijim të IPA II.



»» Strukturat Operuese të programit (klikoni tek ikona për të shkuar tek web - faqja)



Ministry
of European Affairs



Montenegro
Ministry of Finance
Directorate for Finance and Contracting
of the EU Assistance Funds



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministristvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration



**SEKRETARIATI I PËRBASHKËT TEKNIK I IPA
PROGRAMEVE TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR
MALI I ZI - SHQIPËRI DHE MALI I ZI - KOSOVË 2014-2020**

Sekretariati i Përbashkët Teknik – Zyra kryesore

Adresa: Beogradska 17, 81 000 Podgorica, Mal i Zi

Telefon: + 382 20 240 784; + 382 20 240 631;

Sanja TODOROVIC

Drejtuese e Sekretariatit të Përbashkët Teknik

E-mail: sanja.todorovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Maja RADOVIC

Zyrtare për Prokurimet dhe Financat

E-mail: maja.radovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Nikola DJONOVIC

Zyrtar Projekti

E-mail: nikola.djonovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Almir CAUSEVIC

Zyrtar Projekti

E-mail: almir.causevic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Petar BELADA

Asistent Administrativ

E-mail: petar.belada@jts-mne-alb-mne-kos.org

Sekretariati i Përbashkët Teknik – Zyra Antenë Shkodër

Adresa: Rruga Ndoc Çoba, Nr 1 Shkodër, Shqipëri

Telefon: + 355 22 80 20 80;

Nersada MANDIJA

Zyrtare Projekti, Antenë

E-mail: nersada.mandija@saspac.gov.al

Sekretariati i Përbashkët Teknik – Zyra Antenë Prishtinë

Adresa: Kompleksi PRIME, rruga "Tirana", Hyrja D, kati 5, Zyra nr. 53, Prishtinë,
Kosovë

Gazmir RACI

Zyrtar Projekti, Antenë

E-mail: gazmir.raci@jts-mne-alb-mne-kos.org

www.cbc-mne-alb.org | www.cbc-mne-kos.org



@cbc.mne.alb



@cbc.mne.kos



Ky projekt është i financuar
nga Bashkimi Evropian